

SYLLABUSI i Lëndës: BEACH VOLLEYBALL

(Bachelor-zgjedhore)

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT
Titulli i lëndës:	BEACH VOLLEYBALL
Niveli:	BACHELOR
Statusi lëndës:	ZGJEDHORE
Viti i studimeve:	2 -të
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	4
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Bahri Gjinovci
Detajet kontaktuese:	bahri.gjinovci@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p><i>Lënda ofron njohuri të avancuara në metodikën e të mësuarit dhe në procesin stërvitor të volejbollit në rërë, duke i orientuar studentët drejt zhvillimit të kompetencave profesionale dhe shkencore në këtë disiplinë sportive. Përmbajtja e lëndës përfshin studimin e elementeve teknike dhe taktike, veçorive të trajnimit në ambiente të hapura, si dhe zbatimin e rregullave zyrtare të beach volley-it</i></p> <p><i>Gjithashtu, lënda synon të pajisë studentët me njohuri për organizimin dhe menaxhimin e aktiviteteve sportive jashtëshkollore, garave universitare dhe aktiviteteve rekreative, duke i mundësuar atyre aplikimin praktik të koncepteve teorike në kontekstin e edukimit fizik.</i></p>
Qëllimet e lëndës:	<p><i>-Qëllimi i lëndës është të zhvillojë tek studentët kompetenca profesionale, metodike dhe shkencore në procesin e mësimdhënies dhe stërvitjes së volejbollit në rërë. Lënda synon përvetësimin e bazave didaktiko metodike për zhvillimin e elementeve tekniko taktike, planifikimin e stërvitjeve dhe menaxhimin e situatave mësimore në kushte të jashtme.</i></p>

	<p><i>Në kuadër të formimit profesional të studentëve, lënda synon gjithashtu të aftësojë ata për organizimin e seksioneve sportive, garave shkollore dhe ndërshkollore, si dhe aktivitetete rekreative që promovojnë pjesëmarrjen aktive në sport. Përmes këtij procesi, studentët pritet të kuptojnë dhe të vlerësojnë ndikimin edukativ dhe shëndetësor të beach volley-it.</i></p> <p><i>Pas përfundimit me sukses të këtij moduli, studentët pritet të jenë në gjendje të:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <i>-Zbatojnë njohuritë didaktiko–metodike në procesin e mësimdhënies dhe stërvitjes së volejbollit në rërë,</i> <i>-Aftësohen për mësimdhënie praktike të elementeve tekniko–taktike të lojës së Beach Volley-it në nivelet shkollore dhe rekreative,</i> <i>-Planifikojnë, organizojnë dhe udhëheqin seksione sportive, gara shkollore, ndërshkollore dhe aktivitetete rekreative në ambient të hapur.</i>
<p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p>	<p><i>Pas përfundimit me sukses të modulit, studenti do të jetë në gjendje të:</i></p> <p><i>Zbatojë në mënyrë profesionale parimet didaktiko metodike në mësimdhënien dhe stërvitjen e volejbollit në rërë. Analizojë dhe realizojë saktë elementet tekniko taktike të lojës në përputhje me standardet bashkëkohore të trajnimit.</i></p> <p><i>Hartojë plane mësimore dhe stërvitore të strukturuar për nivele shkollore dhe rekreative në ambiente të hapura.</i></p> <p><i>Menaxhojë procesin mësimor në kushte të jashtme duke respektuar parimet pedagogjike dhe të sigurisë.</i></p> <p><i>Zbatojë rregullat zyrtare të lojës dhe organizimin bazë taktik në situata praktike.</i></p> <p><i>Organizojë dhe koordinojë gara shkollore, ndërshkollore dhe aktivitetete rekreative në beach</i></p>

	<p>volley.</p> <p><i>Vlerësojë performancën tekniko taktike dhe të aplikojë metoda adekuate të feedback-ut dhe përmirësimit.</i></p>
Metodologjia e mësimdhënies:	<i>Metoda verbale, e demonstrimit, interactive, te ushtruarit praktik.</i>
Metodat e vlerësimit:	<p><i>Dy teste periodike -I 20 -II 30 pikë</i> <i>Pjesa Praktike 25 pike sem dimr.</i> <i>Seminari 15 pikë</i> <i>Vijimi i rregullt 10 pikë</i></p> <p><i>SUKSESI: 51-60 =6 (E), 61-70=7 (D), 71-80=8 (C), 81-90=9 (B), 91-100=10 (A)</i></p>
Literatura	
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Karakteristikat dhe loja e volejbollit në rërë. Bahri Gjinovci</i> - <i>Libër i ushtrimeve të Volejbollit në rërë, V.Nikqi B.Gjinovci</i> - <i>Rregullat Zyrtare të Volejbollit në Rërë 2021-2024 Publikuar nga FIVB në 2021</i>
Literatura shtesë:	<p><i>www.fivb.com matrialet per edukim</i> www.cev.eu <i>-OFFICIAL BEACH VOLLEYBALL RULES 2021-2024 (Approved by the 37th FIVB World Congress 202)</i> <i>-Beach Volleyball . Karch Kiraly, Byron Shewman</i> <i>-Beach volleyball drill –book,</i></p>
Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	<i>Historiku i Beach Volle-yt</i>
<i>Java e dytë:</i>	<i>Rregullat e lojës</i> <i>Rregullat zyrtare I – Struktura e fushës, ekipi, sistemi i pikëve.</i>
<i>Java e tretë:</i>	<i>Rregullat zyrtare II – Rrotullimi, pozicionimi, veprimet e lejuara dhe të palejuara.</i>
<i>Java e katërt:</i>	<i>Rregullat zyrtare III – Roli i gjyqtarëve, shenjat, protokollet dhe siguria.</i>
<i>Java e pestë:</i>	<i>Procesi i trajnimit për pasimin me gishtërinj përpara</i>

Java e gjashtë:	<i>Procesi i trajnimit për pasimin me çekan</i>
Java e shtatë:	<i>Procesi I trajnimit për shërbimin nga poshtë-shkollor</i>
Java e tetë:	<i>Procesi I trajnimit për shërbimin vlavites</i>
Java e nëntë:	<i>Procesi i trajnimit për shërbimin me kërcim</i>
Java e dhjetë:	<i>Procesi i trajnimit për mësimin e pranimit të shërbimit</i>
Java e njëmbëdhjetë:	<i>Taktika e shërbimeve</i>
Java e dymbëdhjetë:	<i>Taktika e sulmit</i>
Java e trembëdhjetë:	<i>Taktika e mbrojtjes</i>
Java e katërbëdhjetë:	<i>Konceptet kyçe në trajnimin e beach volley-it (parimet bazë mbi të cilat organizohet stërvitja: përgatitja fizike në rërë, teknika dhe taktika në lojën 2x2, komunikimi mes lojtarëve dhe përshtatja me kushtet atmosferike).</i>
Java e pesëmbëdhjetë:	<i>Përbërja e ekipit</i> <i>Vleresimi</i>

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Objektivi i UP-së është të zbatojë konceptet evropiane në arsimin e lartë për të mirën e ekonomisë dhe shkencës, për mirëqenien qytetare, si dhe për interesin e tërë shoqërisë